

**STATUT I SHOQERISE**  
**“OVIS TECHNOLOGIES” Sh.P.K**

*Ky Statut do te konsiderohet se inkorporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise, organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.*

Sot, me **03 Qershor 2024**, personat e meposhtem:

**Z. Kevi Redhaj**, shtetas shqiptar, lindur me 09.04.1994, ne Tirane, Shqiperi e banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr. personal J40409055H, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar,

**Z. Aris Dhiamandi**, shtetas shqiptar, lindur me 06.09.1995, ne Greqi e banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr. personal J50906054A, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar,

ne perputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te ndryshuar dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miratuan kete Statut si vijon:

Ne kete statut:

- “Ligji” eshte Ligji 9901/2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” eshte ky Statut i Shoqerise;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, me 03.06.2024, ne, themeluesit e mesiperm, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin dhe emertimin tregtar “**OVIS TECHNOLOGIES**” SH.P.K.

**Neni 2**


**Objekti**

Brenda kufijve të dispozitave të legjislacionit aktual dhe me respektimin e autorizimeve dhe/ose licencave që mund të kërkohen nga ligji, qëllimi i shoqërisë është: *Tregtimi i mallrave teknologjike.*

**Neni 3**

**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete **e pakufizuar.**



#### Neni 4

##### Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga "Dhimiter Kamarda"; Nd. 39; H. 2; Njesia Administrative Nr. 2; Njesia bashkiake Nr. 1; 1004; Tirane, Shqiperi.

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

#### Kreu II

##### Kapitali

#### Neni 5

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte **100,000 LEKE (njqindmije leke)** dhe zoterohet nga ortakët themelues si vijon:

- **Z. Kevi Redhaj** : Zoterues i **1 (nje) kuote** me vlere te pergjithshme 50,000 Leke (pesedhjetemije leke) qe perben **50 % te kapitalit themeltar te shoqerise;**
- **Z. Aris Dhiamandi** : Zoterues i **1 (nje) kuote** me vlere te pergjithshme 50,000 Leke (pesedhjetemije leke) qe perben **50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.**

Kontributi i ortakut eshte ne para.

#### Neni 6

##### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenskrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet, zvogelimi i prek ortakët ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet: kontributit ne kapitalin e shoqerise, shitblerjes, trashegimise, dhurimit, ose çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj. Çdo disponim ne favor te nje pale te trete nepermjet veprimeve juridike



ndermjet te gjalleve duhet te regjistrohet. Ne rastet e transferimit te pjeseve te kapitalit me kundershperblim, ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### **KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8 Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, i cili pervec kompetencave te tjera te parashikuara ne Ligjin per Shoqerite tregtare ose ne kete Statut, vendos per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te ketij neni;
- f) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfs hire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- m) shperndarjen e fitimeve vjetore;
- n) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetet apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### **Neni 9 Menyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se pergjithshme mund te behet nepermjet nje njoftimi me shkrese ose permes postes elektronike ne adresat e ortakeve, te cilat do t'i njoftohen Shoqerise me shkrim.



Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, të pakten 14 (katërmbëdhjetë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10** **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, më të njëjtin rend ditë.

#### **Neni 11** **Marrja e vendimeve**


Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emerimin e administratorëve; emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

#### **Neni 12** **Perjashtimi nga e drejta e votes**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhenien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



### **Neni 13 Administrimi**

Asambleja e Pergjithshme emerion nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte ripërteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise per nje mandat 5 (pese) vjeçar emerimi: **Z. Kevi Redhaj**, shtetas shqiptar, lindur me 09.04.1994, ne Tirane, Shqiperi e banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr. personal J40409055H, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Administratori do te:

- (i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
- (ii) perfaqesoje Shoqerine;
- (iii) kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;
- (iv) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- (v) krijoje nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
- (vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transakcioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
- (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
- (ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.

Administratori mund te autorizoje persona te tjere per te vepruar ne emer dhe per llogari te tij, duke specifikuar/percaktuar kategoria e akteve dhe veprimeve qe perfaqesuesi mund te kryeje.

### **Kreu IV Viti financiar. Llogaritje vjetore, fitimet dhe rezervat ligjore**

#### **Neni 14 Viti Financiar**

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhete) muajsh e cila fillon 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe mbaron me 31 Dhjetor.



**Neni 15**  
**Ekspertet**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeruje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

**Neni 16**  
**Rezerva Ligjore**

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

**Neni 17**  
**Dividentet**

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe rezultatit financiar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

**Kreu V**  
**Prishja – Riorganizimi i Shoqerise**

**Neni 18**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e Shoqerise mund te behet ne çdo kohe: (i) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj; ose (ii) me vendim te Asamblese se Ortakeve; ose (iii) me hapjen e procedurave te falimentimit; ose (iv) ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723/2007; ose (v) me vendim te gjykates.

Ne kete rast, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesisë paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit qe jane emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete Statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21**  
**Mosmarveshjet**

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e te ciles ka seline Shoqeria.

Ky Statut neshkruhet rregullisht ne gjuhen Shqipe.

**ORTAKET THEMELUES**  
**TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"OVIS TECHNOLOGIES" Sh.P.K.**

**Z. Kevi Redhaj**

**Z. Aris Dhiamandi**

